



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice-Departamenti për  
Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.13/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , të cilin e përfaqëson sipas autorizimit , avokat nga lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. nr. 54/2019, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese , me seli në , të cilën e përfaqëson , seanca është mbajtur në praninë e përfaqësuesit të palës ankuese dhe në praninë e përfaqësuesit të përmbaruesit privat, me datë 22.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat i, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 2,000.00 euro (dymijë), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, nën kërcënimin e përmbarimit.

### A r s y e t i m

Pala ankuese me datë 05.05.2022, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat, pranë të cilës ka mbetur në seancën dëgjimore edhe përfaqësuesi me autorizim i palës ankuese. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me lëndën përmbarimore P. nr. 54/2019 i datës 13.02.2019, ka kryer shkelje të dispozitave

të LPP-së, duke i tejkeluar autorizimet e tij të përcaktuar me ligj, sepse përmbaruesi gabimisht ka vlerësuar kontratën mbi huazimin e mjeteve financiare LRP.nr.1835/2017 e datës 22.05.2017, për faktin se në kontratë ceket që kompetent për përmbarim të kontratës është Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_, poashtu edhe sa i për ketë shumave të obligimit të lejuara sipas propozimit të kreditorit, ku me vendim të gjykatës së lartcekur, duke vepruar sipas prapësimit të palës ankuese PPP.nr.2062/2019 i datës 11.03.2022, konstatohet se përmbaruesi privat e ka tejkeluar autorizimin e tij si organ përmbarues. Me propozim për komisionin që të shqiptohet masa disiplinore.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, me datë 11.05.2022, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit private, si organ përmbarues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi privat në lëndën përmbarimore P. nr 54/2019, me propozim që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë rast.

Përmbaruesi privat, në përgjigjen e tij me shkrim thekson dhe përmes përfaqësuesit të tij në seancën dëgjimore, e kundërshton në tërësi ankesën e palës ankuese si të pabazë, sepse propozimi për Përmbarim i datës 13.02.2019, është lejuar në bazë të Dokumentit Përmbarimor Aktit Noterial, Kontratë mbi Huazimin e Mjeteve Financiare me Lrp.nr.1835/2017 dhe me Ref.nr.972/2017, me date: 22.05.2017, i cili është Dokument Përmbarimor, sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore Neni 22, pika 1.3 - Dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për Noterinë. Mëtej përmbaruesi privat thekson se me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_ me PPP.nr.2062/19 i datës 11.03.2022, Gjykata ka vlerësuar se Kontrata mbi Huazimin e Mjeteve Financiare me Lrp.nr.1835/2017 dhe me Ref.nr.972/2017, datës 22.05.2017, në bazë të së cilës është caktuar përmbarimi është dokument përmbarues i përshtatshëm për përmbarim dhe se Urdhri për përmbarim me P.nr.54/19, është nxjerr konform LPP-së. Poashtu përmbaruesi privat thekson se për sa i përket pjesës së dërgimit të shkresave debitorit-palës ankuese, i janë dërguar shkresat: Propozimin për Përmbarim të lejuar, kërkesën për kthim në gjendjen e fillestare, prapësimin e paraqitur nga Debitori, Përgjigjen në Prapësim dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_ ndërsa Urdhri për Bllokim të llogarive është konfidencial është Dokument, që i dërgohet përmes sistemin RLLB, Bankave Komerciale në Kosovë, pra është Raport në mes Organit Përmbarues dhe Bankave të lartcekura, është informuar pala ankuese, që mund të paraqitet në zyrën e përmbaruesit për ti shikuar të gjitha shkresat sipas nenit 122 të LPK-së. Me propozim për Komisionin Disiplinor që të refuzohet ankesa si e pabazuar.



Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se përmbaruesi privat në këtë rast e ka tejkaluar autorizimet e tij me rastin e caktimit të përbarimit në pjesën e propozimit ku kreditori ka kërkuar që të detyrohet debitori – pala ankuese, që t'i paguaj kamatën prej 8%, në vit dhe fitimit të humbur prej 15%, në vit. Kjo për faktin se me dokumentin përmbarues “Kontrata mbi huazimin e mjeteve financiare Lrp.nr.1835/2017 dhe me Ref.nr.972/2017 e datës 22.05.2017”, në bazë të secilës është caktuar përbarimi, nuk është përcaktuar dhe nuk buron detyrimi që pala ankuese t’ia paguaj kreditorit asnjë shumë tjetër përveç borxhit kryesor, por jo edhe kamatën prej 8%, në vit dhe fitimit të humbur prej 15%, në vit ashtu siç ka kërkuar kreditori me propozim dhe që është lejuar përbarimi duke i shkaktuar dëm palës ankuese në përmbushjen e borxhit kryesor, për këto arsye komisioni vlerëson se përmbaruesi privat në këtë rast ka rënë ndesh me dispozitën e ligjore të nenit 367 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i LPP-së.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin e peshës së dëmit të shkaktuar ndaj palës ankuese, e cila ka dikuar në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368 paragrafi 1 nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe e njëjta do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve e përbarimore, të përmbaruesi privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat, që t’u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përbarimore, në mënyrë profesionale dhe objektive, për çka në thelb, është edhe qëllimi i masës. Ndërsa detyrimin se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 368 paragrafi 3 të LPP-së, në të cilën përcaktohet se gjobat në të holla paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 13/2022 datë 22.06.2022**

**Kryesuese e Komisionit Disiplinor**  
Manushe Karaçi

*M. Karaçi*

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.